



+381



+355



ka ardhë koha!

- Në Kosovë, operatori telefonik mobil “Vala” e shfrytëzon kodin e Monakos (+377), operatori IPKO - kodin e Sllovenisë (+386), ndërsa telefonua fikse e shfrytëzon kodin e Serbisë (+381). Kjo bën që komunikimi midis shfrytëzuesve të kodeve të ndryshme të jetë shumë i shtrenjtë. Përdorimi i vetëm një kodi, atij +355 (i R. së Shqipërisë), do të bënte që komunikimi midis qytetarëve, jo vetëm brenda Kosovës, por duke përfshirë edhe territorin e R.së Shqipërisë të ishte shumë më i lirë. Thirrja Prishtinë-Tiranë do të ishte njësoj sikur thirrja Pejë-Mitrovicë, Sarandë-Prizren etj.
- Shfrytëzimi i këtyre kodeve të huaja, Kosovës, brenda periudhës së pasluftës i ka kushtuar qindra miliona euro. Pse këta miliona të mos mbeten brenda kombit tonë, gjë që do të reflektohej edhe në zhvillimin e tij ekonomik?! Përveç kësaj, kjo kosto do të ishte shumë më e ulët!
- Kodi +355 do ta shkëputte Kosovën nga Serbia edhe në një aspekt dhe do të ndikonte në integrimin dhe lidhjen edhe më të fuqishme të kombit në shumë aspekte.
- Shfrytëzimi i kodit të Republikës së Shqipërisë (+355) është operacion, realizimi i të cilit ka vetëm një pengesë reale: mungesën e vullnetit serioz dhe të sigurt të politikanëve qeverisës.
- E duam 355-shin! I ka ardhë koha!

